



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 korrik 2014
Nr. ref.: RK 672/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KO59/14

Parashtrues

Hilmi Hoxha

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale
dhe të
neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar dhe nënshkruar nga z. Hilmi Hoxha, i cili është paraqitur si kryetar i trupit gjykues të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e disa dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPP) dhe të Ligjit për gjykatat.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe të neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat Nr. 03/L-199, për shkak të konfliktit të pretenduar, lidhur me juridiksionin territorial të gjykatave për përgjegjësi penale.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113. 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 51 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 mars 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 3 prill 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të qartësojë dhe të plotësojë kërkesën, duke iu përgjigjur pyetjeve vijuese:

a) Cila është çështja e përputhshmërisë së këtyre dispozitave ligjore me Kushtetutën?

b) Cila dispozitë ligjore nuk është në përputhje?

c) Çfarë është e pasigurt në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve të kontestuara me Kushtetutën?

d) Si varet vendimi i gjykatës në pritje të rastit nga përputhshmëria e ligjeve në fjalë me Kushtetutën?

e) A ekziston ndonjë vendim i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe/ose të panelit të tij për krime të rënda, që kërkon vlerësimin e përputhshmërisë kushtetuese të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Gjykatat?

8. Më 3 prill 2014, Gjykata gjithashtu kërkoi nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, të dorëzojë:

a) shkresat e lëndës PKR Nr. 317/2013 që është në shqyrtim nga Gjykata Themelore në Gjakovë;

b) çfarëdo vendimi të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe/ose të panelit të tij për krime të rënda, që ngre ose kërkon vlerësimin e përputhshmërisë

kushtetuese të dispozitave të mësipërme të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Gjykatat me Kushtetutën,
c) komentet lidhur me kërkesën, nëse ka;

9. Më 15 prill 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata dhe i dorëzoi shkresat e lëndës PKR Nr. 317/2013.
10. Më 7 maj 2014, Gjykata kërkoi më tej nga Gjykata Themelore në Gjakovë të informojë nëse Kryetari i Gjykatës dhe/ose kryetari i trupit gjykues për Krime të Rënda kishte marrë ndonjë vendim, me të cilin kishte kërkuar vlerësimin e pajtueshmërisë kushtetuese me ligjet e kontestuara dhe, nëse ka, ta dërgojë një kopje.
11. Më 27 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata.
12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor– korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
13. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI59/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović si anëtar të Kolegjit shqyrtues.
14. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 17 shkurt 2004, Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë kishte akuzuar (Aktakuza PP nr. 68/2004) të pandehurin për veprat penale të vrasjes në tentativë si dhe për veprën penale të mbajtjes pa autorizim të armëve dhe municionit.
16. Më 20 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi, P. nr. 154/10) e shpalli të akuzuarin fajtor dhe e dënoi atë për veprat penale sipas aktakuzës.
17. Më 16 prill 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendim PAKR. nr. 899/2012) e aprovoi ankesën e avokatit mbrojtës të të akuzuarit, e anuloi Aktgjykimin (P. nr. 154/2010, të 20 dhjetorit 2011) të Gjykatës së Qarkut në Pejë, dhe e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore në Pejë.
18. Në ndërkohë, më 22 korrik 2010, është nxjerrë Ligji për gjykatat Nr. 03/L-199. Neni 43 (Hyrja në fuqi) parasheh se *“Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse për nenet e tjera fillon të zbatohet nga 1 janari 2013”*.
19. Në pajtim me këtë ligj, ishte themeluar Gjykata e re Themelore në Gjakovë dhe sipas nenit 39.2, të gjitha lëndët të cilat deri më 31 dhjetor 2012 nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, duhet të trajtohen si lëndë të

Gjykatës Themelore, e cila ka juridiksionin territorial përkatës që nga 1 janari 2013.

20. Më 22 tetor 2013, Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Pejë (Aktvendim P. Nr. 270/13) “shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale” për të gjykuar lëndën penale dhe ia dërgoi lëndën Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë.
21. Më 23 tetor 2013, kryetari i trupit gjykues i Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë parashtrroi kërkesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës territoriale me propozim që Gjykata Themelore në Pejë të shpallet kompetente në pikëpamje territoriale, për të vendosur në lëndën penale.
22. Më 25 tetor 2013, Gjykata e Apelit vendosi (Aktvendim PN. nr. 670/2013) se:

“Kompetente për të gjykuar në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë, PP. Nr. 68/04, të datës 17.02.2004, e ushtruar kundër të akuzuarit Engjëll Përkolaj për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale, vrasje në tentativë nga neni 30 alineja 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 19 të LPJ si dhe veprën penale të mbajtjes pa autorizim të armës dhe municionit nga neni 8.3 që ndëshkohet sipas nenit 8.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 “për autorizimin e përdorimit të armëve në Kosovë” është Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti për krime të rënda”.

23. Më 15 janar 2014, kryetari i trupit gjykues të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë, parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
24. Më 28 janar 2014, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi (Aktvendim PML. nr. 16/2014) ta hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke arsyetuar si në vijim:

“Për më tepër, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur një gjyqtar-kryetar i trupit gjykues, subjekt ky i cili nuk ka autorizim ligjor që të paraqes këtë mjet juridik, sepse konform dispozitës së nenit 433. par.1. të KPPK kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij e pas vdekjes së të pandehurit kërkesën mund të paraqesin personat e paraparë me nenin 424. par.1. të këtij Kodi”.

25. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata, si në vijim:

a) *“nenet e KPP-së,” janë dispozita ligjore në përputhshmëri me Kushtetutën, ndërsa neni 39 i Ligjit për Gjykatat, është dispozitë ligjore që bie ndesh me nenet e cekura të KPP-së”;*

b) *“dispozitat juridike të Kushtetutës nuk janë të kontestuar por ndoshta është ndryshimi i imi kur e kam bërë kërkesën lidhur me Kushtetutshmërinë*

e neneve, 29 par. 2, nenit 38 par. 2, te KPP-së, (...) është dashtë të theksohet ligjshmëria e neneve te KPP-së të cekura më lartë”.

c) “Neni 39 par. 2 i Ligjit për Gjykatat, jam i mendimit se nuk është nen i cili përcakton kompetencën territoriale të lëndëve konkrete penale, por caktimi i kompetencës territoriale të secilës lëndë konkrete penale duhet të bazohet në nenin 29 par. 2 dhe nenin 38 par 2 të KPP-së”.

d) “Vendimi i Gjykatës në pritje të rastit varet shumë për arsye se (...), të gjitha këto lëndë dërgohen në Gjykatën Themelore në Gjakovë vetëm me një shkresë të thjeshtë duke u thirrur ne nenin 39 par. 2 të Ligjit për Gjykatat, pa vendim mbi shpalljen in kompetence territoriale, dhe është ngarkesë e veçantë për Gjykatën Themelore në Gjakovë, e cila Gjykatë ka vetëm 3 Gjyqtarë të krimeve të rënda ose gjithsej 12 Gjyqtarë”.

e) “Nuk ka vendim të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, apo të panelit të kësaj Gjykate për krime të rënda, që ka kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë Kushtetuese të Dispozitave Përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Ligjit për Gjykatat”.

26. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës i bashkëngjiti shkresat e lëndës PKR. nr. 317/2013, “meqenëse me këtë lëndë ka qenë i ngarkuar Kryetari i Trupit Gjykses, e jo Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë”.
27. Më 27 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë informoi se “se nuk është marrë vendim me të cilin kërkohet vlerësim i pajtueshmërisë kushtetuese të neneve 29 (2) dhe 38 (2) të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të neneve 11 (1) dhe 39 (2) të Ligjit për Gjykatat nr. 03/L-199, as nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë e as nga gjyqtari kryesues i panelit të krimeve të rënda”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nenet 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat, Nr. 03/L-199 “janë në konflikt me Kodin e Procedurës Penale”, përkatësisht me nenin 29.2 dhe nenin 38.2, me të cilat parashihet juridiksioni territorial i gjykatave.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon “pasigurinë individuale” në vendimet për juridiksionin territorial. Ai më tutje thekson se:

“Në çdo takim, seminar, apo në kolegje, kame kundërshtua mënyrën e përcjelljes së lëndëve penale, dhe jane mundua (...) me e sensibilizua këtë çështje mirëpo mendimi ime ka has në veshe të shurdhët”.
30. Parashtruesi i kërkesës shpreh “pasiguri në lidhje me kushtetutshmërinë e nenit 11 par. 1 dhe nenit 39 par. 2 të Ligjit për Gjykatat, për caktimin e kompetencës territoriale të lëndëve konkrete”.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata “qartësimin e Kushtetutshmërisë që përcakton juridiksioni incidental në lëndën konkrete penale”.

Dispozita relevante të Kushtetutës për gjykata

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

- 1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.
(...)*
- 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
- 4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*

Dispozitat relevante të Ligjit për gjykatat Nr. 03 L-199

Neni 3

- 1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.*
- 2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.*

Neni 11.1

- 1. Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.*

Neni 12

- 1. Departamentet në vijim themelohen brenda Gjykatave Themelore me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre:*

...

- 1.3. Departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;*

- 2. Secila Gjykatë Themelore ka Kryetarin e Gjykatës, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe punën e Gjykatës Themelore. Secila degë e Gjykatave Themelore ka një (1) Gjyqtar Mbikëqyrës që i përgjigjet Kryetarit të Gjykatës Themelore përkatëse për punën e degës.*

Neni 15

- 2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.*

Neni 39.2

- 2. Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale apo Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013*

trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

Dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123

Neni 29.2

2. Kur një veprë penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, kompetente është ajo gjykatë e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje në kërkesën e prokurorit të autorizuar, por nëse procedura nuk është filluar, atëherë kompetente është gjykata në të cilën së pari është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës”.

Neni 38.2

2. Pasi aktakuza të merr formë të prerë, gjykata nuk mund të shpall veten jokompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

Historiku i së drejtës krahasuese

32. Para se të lëshohemi në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konsideron se është e domosdoshme të merret parasysh historiku i së drejtës krahasuese dhe i praktikës gjyqësore.
33. Gjykata vëren se një numër i madh i shteteve evropiane parasheh të ashtuquajturën “*procedurën paraprake të vendosjes*”: një gjykatë e rregullt e ngritë çështjen paraprake në Gjykatën Kushtetuese kur ka dyshime në atë nëse një ligj është në përputhje me Kushtetutën.
34. Procedura paraprake e vendosjes është gjithashtu e njohur si kërkesë gjyqësore, qasje e tërthortë individuale, kontroll konkret, kontroll i tërthortë apo kontroll incidental i kushtetutshmërisë. Duket se komuniteti juridik kosovar është më shumë i familjarizuar me termin kontrolli incidental i kushtetutshmërisë.
35. Në këtë mënyrë, gjykatat e rregullta të shumicës së shteteve janë të autorizuar të parashtrajnë kërkesë për kushtetutshmërinë e legjislacionit. Kjo ekziston në Shqipëri, Armeni, Belgjikë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Itali, Maqedoni, Rumani, Slloveni, Spanjë, Turqi etj. Megjithatë, në disa shtete si në Bullgari, Greqi dhe Letoni, vetëm gjykatat më të larta janë të autorizuar për iniciimin e kontrollit incidental në gjykatat kushtetuese.
36. Nga ana tjetër, në Gjermani, të gjitha panelet kompetente të të gjitha gjykatave në të gjitha rastet kanë të drejtë të shfrytëzojnë kërkesën gjyqësore, në pajtim me nenin 100.1 të Ligjit Themelor. Gjykata Federale Kushtetuese gjithashtu kryen shqyrtimin *ex officio*.
37. Në pajtim me nenin 100.1 të Ligjit Themelor, të gjitha panelet kanë të drejtë të shfrytëzojnë kërkesën gjyqësore. Pastaj, shumica e anëtarëve të panelit duhet të

votojnë që të ngrenë çështjen. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga gjyqtarët të cilët votojnë në favor të kërkesës dhe duhet të shoqërohet nga një deklaratë për dispozitën ligjore në fjalë, dispozitën e Ligjit Themelor të implikuar, dhe për masën e cila është e nevojshme, që një vendim kushtetues të zgjidhë një kontest.

38. Gjykata Federale Kushtetuese do ta hedhë poshtë rastin nëse gjyqtarët referues tregojnë më pak se një bindje të vërtetë se një ligj apo dispozitë e ligjit është jokushtetuese ose nëse rasti mund të vendoset pa zgjidhjen e çështjes kushtetuese.
39. Në Hungari, në pajtim me nenin 24.2 b) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese "*shqyrton menjëherë por jo më vonë se tridhjetë ditë çfarëdo pjese të legjislacionit, të aplikuar në rastin e veçantë për pajtueshmëri me Ligjin Themelor sipas propozimit të ndonjë gjyqtari*".
40. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë, gjykatat e rregullta duhet të iniciojnë procedurën në Gjykatën Kushtetuese, në qoftë se në rastin në procedurë e sipër, ato duhet të aplikojnë rregullat ligjore ose instrumente të tjera ligjore të administratës publike të cilat ato i konsiderojnë jokushtetuese.
41. Procedurë e ngjashme ekziston edhe në Turqi. Në të vërtetë, neni 152 i Kushtetutës së Turqisë, thekson si në vijim:

Nëse një gjykatë e cila është duke e gjykuar një rast, konstaton se ligji ose dekreti që ka fuqinë e ligjit, i cili do të aplikohet, është jo kushtetues, ose në qoftë se ajo është e bindur për seriozitetin e një pretendimi për jo kushtetutshmëri, të paraqitur nga njëra prej palëve, do të shtyjë shqyrtimin e rastit, deri sa Gjykata Kushtetuese të vendosë për këtë çështje.

Nëse gjykata nuk është e bindur për seriozitetin e kërkesës së antikushtetuese, një pretendim i tillë së bashku me aktgjykimin kryesor do të vendoset nga autoriteti kompetent të apelit.

Nëse gjykata nuk është e bindur për seriozitetin e pretendimit për jokushtetutshmëri, një pretendim i tillë së bashku me aktgjykimin kryesor do të vendoset nga organi kompetent i apelit.

Gjykata Kushtetuese vendos për çështjen dhe bën publik vendimin e saj brenda pesë muajve nga pranimi i pretendimit. Në qoftë se asnjë vendim nuk nxirret brenda kësaj periudhe, gjykata e gjykimit do ta përfundojë rastin sipas dispozitave ekzistuese ligjore. Megjithatë, në qoftë se vendimi për meritat e çështjes merr formë të prerë, gjykata e gjykimit është e detyruar ta respektojë atë.

Nuk do të ngrihet asnjë pretendim për jokushtetushmëri në lidhje me të njëjtën dispozitë ligjore deri sa të kalojnë dhjetë vjet pas publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin hidhet poshtë kërkesa sipas meritave.

42. Përveç kësaj, neni 156 i Kushtetutës së Sllovenisë parasheh:

Nëse një gjykatë, e cila vendosë për një çështje e konsideron jokushtetues një ligj të cilin duhet ta aplikojë, duhet ta ndërprejë procedurën dhe të ngre

procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Procedura në gjykatë mund të vazhdojë pasi Gjykata Kushtetuese ta nxjerrë vendimin e saj.

43. Më saktësisht, Akti i posaçëm (i 6 janarit 1989) në Gjykatën Kushtetuese të Belgjikës parashikon:

Neni 27

§ 1. Pyetje paraprake do t'i referohen Gjykatës Kushtetuese nga komunikimi i një kopjeje të vërtetuar të origjinalit të vendimit të referuar, të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i gjykatës.

§ 2 Vendimi i tillë përmban dispozitat e statutit, dekretin ose rregullin e përmendur në nenin 134 të Kushtetutës në lidhje me çështjen e ngritur; kur është e nevojshme, ai gjithashtu specifikon se cilat nene të Kushtetutës ose të ligjeve të veçanta janë të rëndësishme në këtë drejtim. Gjykata Kushtetuese, megjithatë, mund të riformulojë çështjen e ngritur paraprake.

Neni 28

Gjykata e cila e parashtroi çështjen paraprake dhe çdo gjykatë tjetër, e cila nxjerrë aktgjykim për çështjen e njëjtë, duhet t'i përmbahet vendimit të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me pyetjen e ngritur, të bërë në nenin 26.

Neni 29

§ 1 . Nuk do të ketë asnjë mjet juridik kundër një vendimi të një gjykate të ligjit për aq sa ajo i referohet një çështjeje në Gjykatën Kushtetuese për një vendim paraprak.

§ 2 . Çdo vendim, me të cilin një gjykatë refuzon për ta ngritur një çështje për një vendim paraprak duhet të përmbajë arsyen e refuzimit. Nuk ka mjet juridik të veçantë kundër vendimit të një gjykate që refuzon për të ngritur një çështje të tillë .

Neni 30

Vendimi për ta ngritur një çështje në Gjykatën Kushtetuese për një vendim paraprak ka efektin e pezullimit të procedurës dhe afateve kohore për procedura dhe periudhat e parashkrimit nga data e këtij vendimi deri në datën në të cilën vendimi i Gjykatës Kushtetuese i komunikohet gjykatës së ligjit, e cila kishte ngritur çështjen paraprake. Një kopje e vendimit i dërgohet palëve.

44. Gjykata konsideron se është një përmbledhje e drejtë e pikëpamjes krahasuese nëse thuhet se në shumicën e shteteve evropiane, gjykatat e rregullta mund ta shfrytëzojnë kërkesën gjyqësore. Pastaj një vendim për ngritjen e çështjes kushtetuese, duhet të nxirret, të votohet dhe të nënshkruhet. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga gjyqtarët të cilët kishin votuar në favor të kërkesës dhe duhet të shoqërohet nga një deklaratë për dispozitën ligjore në fjalë, dispozitën e implikuar të Kushtetutës, dhe masën e cila është e nevojshme, që një vendim kushtetues të zgjidhë një kontest. Përveç kësaj, vendimi i nënshkruar sipas rregullit nga gjyqtari ose gjyqtarët, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i gjykatës ose nga sekretari.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata tani shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar.
46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar dhe nënshkruar kërkesën, “*në pajtim me nenin 113 pika 8 të Kushtetutës së Kosovës*”, i gatshëm “*të referoim pyetjen në lidhur me Kushtetutshmërinë e këtyre neneve - Ligjeve të cekura me lartë dhe kërkoim qartësimin e Kushtetutshmërisë që përcakton juridiksioni incidental në lëndën konkrete penale*”.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:
1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
(...)
 8. *Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë“.*
48. Gjykata i referohet edhe nenit 51 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:
1. *Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.*
 2. *Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.*
49. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 75 [Parashtrimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- (1) *Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.*
 - (2) *Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.*
 - (3) *Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore“.*

50. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.8 të Kushtetutës si bazë juridike për paraqitjen e kërkesës.
51. Gjykata rikujton se deri më tani ka pasur vetëm një rast të dorëzuar në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, (shih rastin Gjykata Kushtetuese KO04/11, Aktgjykimi i 6 marsit 2012).
52. Në atë rast, seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme ka shqyrtuar dorëzimin e një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë, në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës.
53. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë në emër të Gjykatës Supreme, nga kryetari i saj, z. Fejzullah Hasani.
54. Në fillim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjyqtari Hilmi Hoxha, informoi se nuk ka vendim gjyqësor, të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë ose nga trupi gjykues i Krimeve të Rënda, me të cilin kërkohet nga Gjykata Kushtetuese vlerësimi i pajtueshmërisë kushtetuese të dispozitave të kontestuara ligjore.
55. Gjykata vëren se Kushtetuta (neni 102) dhe Ligji për gjykatat (neni 3) bën dallim në mes të “*gjykatave*” dhe “*gjyqtarëve*”. Nga ana tjetër, e drejta krahasuese, neni 113.8 i Kushtetutës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (neni 51) dhe Rregullorja e punës (rregulli 75), kur kanë të bëjnë me kontrollin incidental, gjithmonë i referohen një “*gjykate*”.
56. Kështu, Gjykata konsideron se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një “gjykatë”, siç përcaktohet në legjislacionin e përmendur më lart dhe, më saktësisht, në nenin 113.8 të Kushtetutës.
57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenin 51 të Ligjit dhe rregullin 75 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË KTHEHEN shkresat e lëndës në Gjykatën Themelore në Gjakovë
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani